



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 mars 2026
Nr. ref.:VMP 2984/26

**VENDIM PËR VENDOSJEN E
MASËS SË PËRKOHSHME**

në

rastin nr. KO72/26

parashtues

Qeveria e Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit [nr.24/2026] të 6 marsit 2026 të
Presidentes së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtuesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin mëtejme: Parashtuesi i kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Dekretit [nr. 24/2026], të 6 marsit 2026, të Presidentes së Republikës së Kosovës për shpërndarjen e Legjislaturës së Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Akti i kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të kontestuar për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i njëjti nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, duke theksuar se *“[...] pezullimi i menjëhershëm i veprimet të Dekretit nr. 24/2026 përbën një masë të domosdoshme për tu parandaluar pasoja potencialisht të pariparueshme për rendin kushtetues, për funksionimin demokratik të institucioneve dhe për interesin publik të Republikës së Kosovës.”*

Baza juridike

5. Kërkesa është parashtruar bazuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 29 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 65 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 mars 2026, Parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike dorëzoi kërkesën në Gjykatë, të cilën kjo e fundit e regjistroi më 9 mars 2026.
7. Më 9 mars 2026, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KO72/246] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO72/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
8. Më 9 mars 2026, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Kryeministrin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, duke i kërkuar plotësimin e kërkesës përmes dorëzimit të kopjes së Aktit të kontestuar; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja) e cila u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; dhe (iii) Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetarja e Kuvendit), të cilës iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në njoftimet e lartcekura u përcaktua që afati për dorëzimin e komenteve dhe plotësimin e kërkesës është data 11 mars 2026.
9. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktin e kontestuar.

10. Më 9 mars 2026, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja lidhur me kërkesën KO72/26. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
11. Më 9 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtarës raportuese përkitazi me kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme. Në po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që (i) të caktojë *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës masën e përkohshme me të cilën ndalohet çdo veprim i Presidentes së Republikës Kosovës në lidhje me Dekretin [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026, si dhe të ndalojë çdo veprim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kohëzgjatjen e përcaktuar sipas pikës II të këtij Vendimi; (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 9 mars 2026, në kohëzgjatje deri më 31 mars 2026; (iii) t'ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe që (v) Vendimi hyn në fuqi më 9 mars 2026.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 5 mars 2026, Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazuar në kërkesën e 42 (dyzet e dy) deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETVENDOSJE!, mbajti seancën e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës *“Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”*.
13. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, të 5 marsit 2026, rezulton se u propozuan 2 (dy) kandidatë për President të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca dhe Fatmire Mullhaxha – Kollçaku.
14. Kryetarja e Kuvendit konstatoi se në sallë ishin prezent 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) deputetë. Rrjedhimisht si rezultat i mungesës së prezencës së 2/3 të deputetëve, Kryetarja e Kuvendit ndërpreu seancën e jashtëzakonshme.
15. Më 6 mars 2026, Presidentja, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës nxori Dekretin [nr. 24/26] përmes së cilit theksohet: *“1. Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, specifikon që: *“[...] shpërndarja e Kuvendit përmes dekretit antikushtetues, pa u shterur afati 60-ditor, duke ua ndërprerë mandatin deputeteve dhe duke e dërguar Qeverinë në dorëheqje, (shih Ligjin 08/1-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 30, par. 2, pika 2.1), ku parashihi kufizime të mëdha ligjore në funksionimin e saj (shih po aty, neni 31), përbën shkelje të rëndë të rendit kushtetues, konkretisht të dispozitave kushtetuese të përcaktuara në pikën II të kësaj kërkeje [“nenin 86, par. 2, nenin 82, par. 1.3, nenin 84, par. 2, nenin 4, par. 3, nenin 7 dhe nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”].*

Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë *“masë të përkohshme ndaj dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës. Ndaj, lejimi i shpërndarjes së Kuvendit pa një vlerësim paraprak nga Gjykata Kushtetuese krijon një precedent të rrezikshëm të menjëhershëm, por edhe për të ardhmen e stabilitetit institucional dhe funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës. Veprimet*

parandaluese në këtë rast nga Gjykata janë të domosdoshme, pasi ndërhyrja vetëm pas materializimit të pasojave do të jetë e vonuar”.

18. Në këtë drejtim parashtuesi i kërkesës thekson se: *“Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se në këto rrethana ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm që, përpara se Gjykata Kushtetuese të vendosë mbi themelin e kësaj çështjeje, të krijohen pasoja faktike dhe institucionale të cilat do të ishin jashtëzakonisht të vështira për t’u korrigjuar në rast se më vonë konstatohet se akti i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën. Fillimi i procedurave për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme do të përfshinte një sërë veprimesh institucionale dhe administrative, duke filluar nga caktimi i datës së zgjedhjeve, aktivizimi i procedurave zgjedhore, mobilizimi i administratës zgjedhore, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe angazhimi i burimeve publike, të cilat, pasi të jenë ndërmarrë, do të krijojnë një gjendje faktike që do të ishte tejte e vështirë të rikthehej në gjendjen e mëparshme kushtetuese.”*
19. Tutje, parashtuesi i kërkesës thekson që: *“[...] lejimi i vijimit të efekteve juridike të dekretit të kontestuar, përfshirë edhe nxjerrjen e një dekreti të mëtejme për caktimin e datës së zgjedhjeve, do të prodhonte pasoja të thella për funksionimin e rregullt të institucioneve kushtetuese të Republikës. Një zhvillim i tillë do të ndikonte drejtpërdrejtë në ushtrimin e pushtetit legjislativ, në funksionimin e pushtetit ekzekutiv dhe në stabilitetin institucional të Republikës së Kosovës, duke krijuar një situatë të pasigurisë juridike dhe institucionale që do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të sundimit të ligjit dhe të rendit kushtetues demokratik.”*
20. Si rrjedhojë, parashtuesi i kërkesës specifikon që: *“[...] pezullimi i menjëhershëm i veprimit të Dekretit nr. 24/2026 përbën një masë të domosdoshme për të parandaluar pasoja potencialisht të pariparueshme për rendin kushtetues, për funksionimin demokratik të institucioneve dhe për interesin publik të Republikës së Kosovës. Vendosja e masës së përkohshme do të siguronte ruajtjen e status quo-së kushtetuese deri në momentin kur Gjykata Kushtetuese të vendosë përfundimisht mbi kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar, duke garantuar kështu efektivitetin e kontrollit kushtetues dhe mbajtjen e stabilitetit institucional të shtetit.”*
21. Në vijim, parashtuesi i kërkesës sqaron se: *“Vendosja e masës së përkohshme imponohet gjithashtu nga një rrethanë tjetër me peshë të veçantë kushtetuese. Pas nxjerrjes së Dekretit të kontestuar nr. 24/2026, në të njëjtën ditë, me 6 mars 2026, Presidentja e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapat e parë për materializimin e efekteve të tij juridike, përkatësisht përmes thirrjes së partive politike në një takim konsultativ lidhur me caktimin e datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Nëse dekreti i kontestuar do të mbetej në fuqi, zgjedhjet do të duhej të mbaheshin brenda afatit kushtetues prej dyzet e pesë (45) ditësh, duke e shndërruar kështu këtë akt në një proces institucional të pakthyeshëm në praktikë. Në këto rrethana, rreziku kushtetues nuk është me hipotetik, por i menjëhershëm dhe real. Ai konsiston në krijimin e një situatë faktike që, edhe në rast të konstatimit të mëvonshëm të antikushtetutshmërisë nga Gjykata, do të ishte jashtëzakonisht e vështirë të rikthehej në gjendjen e mëparshme juridike.”*
22. Përkitazi me këtë, parashtuesi i kërkesës thekson se: *“[...] masa e përkohshme është thelbësore për të shmangur dëme të pariparueshme dhe pasoja të pakthyeshme, përfshirë kosto të mëdha financiare, pasiguri të thellë politike, vonesa në reforma dhe dobësim të sundimit të ligjit dhe demokracisë në vend.”*
23. Në vijim, parashtuesi i kërkesës thekson që: *“shpërndarja e Kuvendit e pamundëson në tërësi ushtrimin e pushtetit legjislativ, duke përfshirë miratimin e ligjeve dhe*

marrëveshjeve ndërkombëtare, mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, propozimin apo zgjedhjen e anëtarëve të disa prej institucioneve kyçe të Republikës, si dhe shumë funksione të tjera kushtetuese të Kuvendit (shih Kushtetutën, neni 65). Çdo ditë e këtij pamundësimi të plotë të ushtrimit të pushtetit legjislativ sjell dëme të mëdha dhe të pariparueshme për qytetarët e Republikës. Për shembull, në rend të ditës për seancën e radhës të Kuvendit ka qenë shqyrtimi i katër marrëveshjeve ndërkombëtare, me vlerë prej rreth 121 milionë euro gjithsej. Për të shmangur vonimin dhe potencialisht edhe humbjen e këtyre mjeteve, si dhe vonimin dhe potencialisht humbjen e mjeteve të tjera, është e domosdoshme vënja e masës së përkohshme për pezullimin e shpërndarjes së Kuvendit gjatë kohës kur Gjykata po e shqyrton këtë lëndë kushtetuese.”

24. Parashtruesi i kërkesës, në vijim thekson që: *“shpërndarjen e Kuvendit, pamundësimi i plotë i ushtrimit të pushtetit legjislativ shoqërohet po ashtu, siç u cek më lart, me dobësimin substancial të pushtetit ekzekutiv, duke e shndërruar një Qeveri funksionale dhe fuqiplotë në një Qeveri në dorëheqje me kompetenca rreptësisht të kufizuara. [...] Në këtë mënyrë, shpërndarja e Kuvendit është duke sjellë tashmë, dhe do të vazhdojë të sjellë në të ardhmen, dëme të pariparueshme që prekin drejtpërsëdrejti interesat e qytetarëve të Republikës. Vetëm vënja e masës së përkohshme dhe pezullimi i dekretit të Presidentes mund të shmangin këto pasoja. Pikërisht për shkak të këtyre dëmeve të pariparueshme, të cilat rrjedhin prej pamundësimi të plotë apo të pjesshëm të ushtrimit të dy prej pushteteve kyçe të shtetit të Kosovës, është qartazi në interesin publik që dekreti i Presidentes të pezullohet. Interesi publik i qytetareve të Republikës është që të ketë, në çdo kohë, institucione funksionale shtetërore. Kjo vlen sidomos kur institucionet në pyetje janë Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Pezullimi i dekretit të Presidentes është i domosdoshëm për të garantuar stabilitetin, funksionalitetin dhe vazhdimësinë institucionale gjatë kohës që po vlerësohet kushtetutshmëria e tij. Në këtë mënyrë, plotësohet edhe kushti i dytë për vënien e masës së përkohshme, që ajo të jetë në interesin publik.”*
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës konsideron se: *“Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës duhet të aprovojë kërkesën e tyre për masë të përkohshme, sepse parashtruesi konsideron se kanë dorëzuar një kërkesë e cila është “prima facie” e pranueshme dhe është substancialisht e arsyetuar rreth pretendimeve përkitazi me dispozitat kushtetuese të saktësuara në kërkesë. Po ashtu, vendosja e masave të përkohshme është në interesin publik, i shërben administrimit të drejtësisë dhe është në shërbim të ruajtjes së rendit kushtetues, sundimit të ligjit, si dhe parimit të demokracisë dhe respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.*

Vlerësimi përkitazi me masën e përkohshme

26. Bazuar në faktet e elaboruara si më sipër, Gjykata vë në dukje që Presidentja, më 6 mars 2026 nxori Dekretin [nr. 24/26] përmes së cilit theksohet: *“1. Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*
27. Gjykata, tutje vë në dukje që parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme ndaj Dekretit të Presidentes përmes të cilës, ndër tjerash specifikon që: *“[...] vendosja e masës së përkohshme rezulton e domosdoshme edhe për shkak të zhvillimeve të mëtejme institucionale që lidhen drejtpërdrejt me aktin e kontestuar.”* Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës shton: *“[...] se në këto rrethana ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm që, përpara se Gjykata Kushtetuese të vendosë mbi themelin e kësaj çështjeje, të krijohen pasoja faktik edhe institucionale të cilat do të ishin jashtëzakonisht të vështira për t’u korrigjuar në rast se më vonë konstatohet se akti i kontestuar nuk është në përputhje me Kushtetutën.”*

28. Lidhur me vlerësimin e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton:

“[...]

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

[...].”

29. Gjithashtu, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.”

30. Në fund, Gjykata rikujton paragrafët 1 dhe 2 të rregullit 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë që:

“1. Në çfarëdo kohe, përderisa Gjykata të mos ketë vendosur lidhur me një kërkesë, çdo palë mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj, siç përcaktohet me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit.

2. Gjykata po ashtu mund të vendosë masë të përkohshme ex-officio, lidhur me një çështje që është objekt i procedurës para saj, nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për një gjë të tillë sipas neni 27 të Ligjit.

[...].”

31. Ashtu siç është theksuar edhe përmes praktikës gjyqësore, në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata në vazhdimësi ka përsëritur që në shërbim të ruajtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës i cili bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burim i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese si organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe autoriteti që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, rritet rëndësinë e ndalimit të çdo veprimi ose vendimi të mëtejshëm nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të afektuara nga Akti i kontestuar.
32. Gjykata thekson se vendosja e masës së përkohshme ex officio dhe sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës përmes të cilës ndalohet ndërmarrja e çdo veprimi nga Presidentja lidhur me Dekretin [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026 si dhe ndalimit të çdo veprimi të Kuvendit deri në vendosjen e rastit nga Gjykata Kushtetuese është në funksion të parandalimit të shkaktimeve të dëmit të pariparueshëm për rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe funksionimin demokratik të institucioneve kyçe në Republikën e Kosovës.
33. Në kuptim të përcaktimeve të nenit 27 të Ligjit, Gjykata vlerëson se ndalimi i çdo vendimi dhe veprimi të mëtejshëm nga ana e institucioneve të lartcekura është në interes

publik, i domosdoshëm për ruajtjen e rendit kushtetues dhe interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

34. Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykuar meritat e kërkesës KO72/26 konstaton se duhet të vendoset masa e përkohshme *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtresit të kërkesës në përputhje me arsyetimin e këtij Vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 116 (2) të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe rregullat 44, 45, 46 (2) dhe 48 (1) (d) të Rregullores së punës, më 9 mars 2026, njëzëri

VENDOS

- I. TË CAKTOJË *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtresit të kërkesës masën e përkohshme me të cilën ndalohet çdo veprim i Presidentes së Republikës Kosovës në lidhje me Dekretin nr. 24/2026 të 6 marsit 2026, si dhe të ndalojë çdo veprim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kohëzgjatjen e përcaktuar sipas pikës II të këtij Vendimi;
- II. TË URDHËROJË që masa e përkohshme hyn në fuqi më 9 mars 2026, në kohëzgjatje deri më 31 mars 2026;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Vendim hyn në fuqi më 9 mars 2026.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi-Peci

Nexhmi Rexhepi